

zbrazur. Shtatë ditë më vonë, në një livadh prapa shtëpisë i kishte gjetur rrobat që i takonin Sylejmanit, ndërkaq afër tyre edhe një varr. E ftoi axhën e saj. Ai, më pas, e njoftoi policinë serbe, e cila i kreu hetimet në vendin e ngjarjes. E hapën varrin dhe në të e identifikuan kufomën e Sylejmanit në bazë të mustaqeve dhe ndërresave të brendshme. Ishte qëlluar me një plumb. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Sylejmanin në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata Z.G, FDH-18940; deklarata F.C, FDH-34334; KMKRKF, *Personat...*, FDH-10832.

Fadil (Avdyl) Salimusa

(18.05.1975, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, i pamartuar)

Fadil me vëllain Mejdinin ndenjën me gjyshen e tyre Fahrijen në Rahovec/Orahovac, pas hyrjes së forcave serbe më 18.07.1998. Në datën **21.07.1998**, në mes të orës 13:00 dhe 14:00, Fadili shkoi ta vizitonte hallën në rrugën *Kral Petar I [Rahovec/Orahovac]*. Nuk u kthye më. Afro 20 minuta më vonë, Mejdini i ka dëgjuar disa të shtëna. Iu kujtua i vëllai, e kaploi frika për të dhe për mundësinë se diçka e keqe ka mundur t'i ndodhte, por nuk kishte guxim të dilte jashtë shtëpisë. Një ditë më vonë, policia serbe e ka arrestuar Mejdinin, sikurse dhe shumë shqiptarë të tjerë në Rahovec/Orahovac, kështu që për një kohë të gjatë ai nuk diti se të vëllain ia kishin vrarë. Dëshmitari i vrasjes së Fadilit ka qenë vendasi Qemal Durguti, i cili për këtë e ka njoftuar nënën e tij. Trupin e pajetë të Fadilit më 25.07.1998 e kanë marrë disa romë, të cilët policia serbe i kishte angazhuar që t'i mblidhnin dhe varrosnin trupat e shqiptarëve të vrarë. Në fillim të muajit nëntor të vitit 1999, trupi i Fadilit u zhvarros nga varreza masive pranë varrezave të qytetit. Familjarët e kanë varrosur Fadilin më 18.11.1999 në varrezat e Rahovecit/Orahovac.

Burimet: deklarata M.S, FDH-40582; J. Osmani, *Krimet...*, II, 248.

Qamil (Sherif) Iska

(13.05.1928, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, pensionist, tetë fëmijë)

Hajrije (Bilall Veliu) Iska

(4.06.1934, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, tetë fëmijë)

Qifti bashkëshortor Qamili dhe Hajrija jetonin në bashkësi familjare me djalin Asimin dhe familjen e tij. Hajrija ishte e sëmur shumë. Ditën e shtunë, më 18.07.1998, në përpjekje që të gjenin vendin e sigurt, ata kaluan te vajza Bukurija, ndërkaq të dielën, të gjithë u strehuan në shtëpinë e djalit Miftaremit, i cili jetonte në Gjermani. Qamili e bartte Hajrijen në shpinë. Ditën e hënë, të gjithë të rinjtë e braktisën **Rahovecin/Orahovac** dhe shkuan në Malishevë/Mališevo. Por, Qamili dhe Hajrija e palëvizshme ndenjën në shtëpinë e Miftaremit. Ata mbahen në mend të shiheshin të gjallë herën e fundit ditën e martë [**21.07.1998**], nga ora 14:00, në udhëkryqin Malishevë/Mališevo – Rahovec/Orahovac – Xërxë/Zrze. Qamili e shtynte karrocën e dorës, mbi të cilën ishte ulur Hajrija. Më 3.08.1998, trupat e tyre të pajetë janë gjetur të vendi i quajtur *Mulla Shaipovo llojze*, në afërsi të vendit *Të Rrasat/Ploçe*. Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur Qamilin dhe Hajrijen në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-850; deklarata B.M, FDH-33030; KMKRKF, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00614, FDH-35527.

Dejan (Filip) Trifunović

(12.08.1974, serb nga Videja/Vidanje, komuna e Klinës/Klina, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dejani e ka mbaruar shkollën e mesme mekanike dhe trajnimin për policinë. Jetonte në bashkësi familjare me prindërit e vet në fshatin Videjë/Vidanje, në afërsi të Klinës/Klina. Punonte si pjesëtar i policisë rrugore pranë SPB-së së Prizrenit/Prizren. Ka gjetur vdekjen në luftimet me forcat e UÇK-së, që janë zhvilluar më **21.07.1998**, në **Rahovec/Orahovac**. Ka rënë te vendi i quajtur *Krasta e Vogël/Mala Krasta*,